



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 67/2012
Prishtinë, më 19.06.2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Berat Buzhala.

Pjesëmarrës të tjerë: Ekrem Hoxha, Ilir Imeri, Irena Bryma dhe Visar Halimi - ART; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja – INDEP; Haxhi Gashi – USAID/GFSI dhe Florije Mehmeti – KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.05.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për metrologji;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit për vitin 2011;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Deputeti **Lutfi Zharku** propozoi që pika e katërt e rendit të ditës të vihet në rend dite para pikës së tretë, për shkak të pjesëmarrjes fizike të kryetarit të Bordit të ART-së.

Rendi i ditës u miratua duke përfshirë propozimin e deputetit Zharku.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.05.2012

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.05.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011

Kryetari i Komisionit Zenun Pajaziti – Ia dha fjalën kryetarit të Bordit të ART-së, z. Ekrem Hoxhës që shkurtimisht ta prezantojë raportin e ART-së për vitin 2011.

Ekrem Hoxha (kryetar i Bordit të ART-së) – Paraqiti ekspozë të raportit, i cili theksoi se raporti është hartuar brenda afatit ligjor dhe në përputhje me kërkesat që parasheh Ligji për telekomunikacionin. Ai tha se gjatë vitit 2011 numri i operatorëve të rinj të licencuar për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese, kryesisht atyre me vlerë të shtuar dhe shërbimeve të internetit, është 38, ndërsa totali i operatorëve të licencuar në fund të vitit 2011 ishte 86, krahasuar me 48 në fund të vitit 2010. Ai përmendi sfidat të cilat po e përcjellin edhe më tutje ART-në, siç janë: vazhdimi i operimit të operatorëve ilegalë mobilë në pjesën veriore të Republikës së Kosovës; infrastruktura e rrjetit të telefonisë fikse dhe infrastruktura kablllore, fibrë optik të operatorit Telekom Serbia në zonat e banuara nga komuniteti etnik serb; vazhdimi i ofrimit të shërbimeve-dërgesave postare në zonat e banuara nga komuniteti etnik serb; vazhdimi i kontradiktave në interpretim të dispozitave të ligjit të telekomunikacionit dhe rregulloreve të ART-së nga disa institucione dhe autoritete dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare. ART-ja, tha z. Hoxha, ka vazhduar me nxjerrjen e akteve nënligjore, dhe gjatë vitit 2011, ART-ja ka adoptuar dhe miratuar aktet rregullatore dhe administrative si në vijim: Rregullorja për sigurimin e qasjes, rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për licencë dhe autorizime, Rregullorja për bashkëshfrytëzimin e plotë dhe të përbashkët të Lakut Lokal, Rregullorja për interkoneksion, Rregullorja për operimin e nyjës shkëmbyese të internetit, Rregullorja për të dhënat statistikore periodike të operatorëve të shërbimeve telekomunikuese dhe postare, Rregullorja mbi parimet dhe procedurat e inspektimit të zhvilluara nga ART-ja. Ai po ashtu tha se kemi vazhduar me shqiptimin e gjobave dhe gjatë këtij viti janë shqiptuar 6 dënime. Janë marrë në shqyrtim 5 raste të ankesave të qytetarëve (konsumatorëve), duke i përmbysur dhe zgjidhur ato përmes marrëveshjeve sqaruese dhe rekomanduese ndaj operatorëve. Po ashtu, z. Hoxha tha se janë administruar 3 procese për zgjidhjen e konflikteve dhe arbitrimin mes operatorëve të licencuar. “ART-ja ka vazhduar me avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit profesional dhe administrativ për të siguruar punë efektive dhe me efikasitet më të lartë, duke mbajtur në fokus angazhimin drejt ndërtimit të një kuadri me staf profesional dhe të përgjegjshëm”- tha në fund të prezantimit të raportit kryetari i Bordit të ART-së z. Ekrem Hoxha. Z.Hoxha tha se për çfarëdo sqarimi shtesë lidhur me raportin jemi të gatshëm të përgjigjemi.

Kryetari i Komisionit, **Zenun Pajaziti** falënderoi z. Hoxha për prezantimin dhe i drejtoi disa pyetje përfaqësuesve të ART-së. Ai kërkoi nga përfaqësuesit e ART-së që të japin komentet e tyre lidhur me sfidat e Raportit të Progresit, si është gjendja e sfidave të përmendura në Raport të

Progresit, pasi që si sfida janë përmendur pavarësia financiare e ART-së, kapaciteti administrativ i Departamentit të Shërbimeve Postare, ende nuk ka kod telefonik ndërkombëtar, emër të domenit të kodit të internetit për shtetin. Po ashtu, z. Pajaziti, duke iu referuar raportit të ART-së për vitin 2011 ku thuhet se ART-ja ka kontradikta në interpretim të ligjit për telekomunikacionin, me disa institucione dhe autoritete, tha se a do të mundemi t'i tejkalojmë këto kontradikta me ligjin e ri, i cili pritet të miratohet së shpejti.

Teuta Sahatqija - Kërkoj sqarime lidhur me sfidat që ART-ja është përballur lidhur me ngritjen e një shkëmbyes të internetit, lakun lokal, dhe po ashtu pyeti se ku qëndron ART-ja me përgatitjet për gjeneratën e 4 (4G) dhe a ka pasur kërkesë të kalohet drejtpërdrejt në 4G, duke tejkaluar 3G.

Visar Ymeri - Theksoi se është e rëndësishme që raportet të krahasohen me planet zhvillimore afatgjata të sektorit. Ai tha se raportet që po na vijnë neve, nuk po krahasohen me një plan afatgjatë. Deputeti Ymeri i bëri disa pyetje përfaqësuesve të ART-së, si: A keni vërejtur rënie të çmimit të telefonisë fikse dhe mobile, si rrjedhojë e liberalizimit të tregut? Penetrimi i telefonisë fikse është në rënie, cila është arsyeja, a është dashur ART-ja të bëjë diçka në këtë drejtim? Lidhur me ndarjen e tregut vërehet një rënie e vazhdueshme e operatorit Vala dhe kjo duket se është më tepër pasojë e operatorit virtual Z Mobile, i cili po ia merr konsumatorët Valës, sesa konkurrenca e IPKO-s, a mendoni se kjo kontratë po e dëmton shumë operatorin Vala, a mendoni se Kosova ka domosdoshmëri të ketë operator virtual?

Hashim Deshishku - Lidhur me sfidat për pavarësinë financiare pyeti se a ka qenë problem interpretimi i ligjit, Ministria e Financave, apo ku ka qenë problemi, çka mendoni se duhet të bëjmë ne që ju të keni pavarësi financiare? Pse nuk janë realizuar investimet kapitale, ka qenë problem shkurtimi i buxhetit për investime kapitale, cila është arsyeja? Investimet në telefoninë mobile janë rritur në vitin 2011, ndërsa në atë fikse është zvogëluar shumë, a do të thotë që si pasojë e zvogëlimit të investimeve në telefoninë fikse kemi rënie të përdorimit të telefonisë fikse, apo ku qëndron arsyeja e rënies së telefonisë fikse? Ku ka arritur marrëveshja për kodin telefonik? Lidhur me konkurrencën ka shumë dallime, në telefoni mobile dominon Operatori Vala, në internet dominon IPKO-ja, nëse mund të na sqaroni më shumë për ndarjen e tregut.

Myzejene Selmani - Tha se viti i kaluar ka qenë vit i mirë për ART-në, sepse është miratuar plani kombëtar i shpërndarjes së spektrit frekuencor. Ajo pyeti se a jemi gati të fitojmë kodin e telefonisë fikse dhe mobile. Po ashtu, deputetja Selmani kërkoj më tepër sqarime për operatorët ilegalë në veri të Kosovës, për investimet e operatorëve të cilat janë 24% më të larta se në vitin 2010, për numrin e të punësuarve nga operatorët e licencuar, sidomos në PTK, që vazhdon të ketë numër më të madh me rreth 80% të të punësuarve në këtë sektor. Ajo shtoi se, sipas raportit, të hyrat e PTK-së janë rritur, kurse numri i konsumatorëve të cilët kanë telefoninë mobile nuk është rritur, ndoshta është rritur vetëm konsumi i tyre. Në vazhdim, ajo kërkoj sqarime për çështjen e PTK-së dhe IPKO-s, si dhe operatorëve virtualë se a paguajnë shfrytëzimin e rrjetit, lidhur me veprimtarinë juridike të ART-së për kontestin mbi çështjen për ndërprerjen e njëanshme të marrëveshjes (kontratës) komerciale për qiradhënien e fijeve optike.

Ramiz Kelmendi – Pyeti: A janë të gjithë operatorët të pajisur me arka fiskale dhe a është i blombuar sistemi i shitjes së impulseve dhe si përcillen kartelat për shitje?

Ekrem Hoxha - Iu përgjigj pyetjeve të parashtruara nga ana e deputetëve. Lidhur me komentimin për formatin e raportit, tha se politika e Ligjit të ART-së, nënkupton mbikëqyrje dhe referim minimal kur atëherë paraqitet nevoja e ndërhyrjes, ky është koncepti i parimit rregullator, ndërhyrje minimale në konceptin për parandalim të konfliktit të konteksteve mes të operatorëve konkurrues të caktuar, duke pasur parasysh që këto janë standardet e operimit dhe të rregullimit

në nivel të vendit. ART-ja, si autoritet rregullator, e zbaton ligjin sipas dispozitave dhe zbaton politikat e sektorit, i cili është kompetent i Qeverisë. Njoftoi se ka një sektor të telekomunikacionit nga viti 2007, i cili është i tejkaluar, por është edhe si dokument i politikave, i cili nuk parasheh objektiva të afatizuara se kur duhet të arrihet kjo, por e gjitha kjo cilësohet si një plan më afatgjatë, ashtu si është paraparë në praktikën ekonomike. Rregullimi nënkupton se nuk mund të devijojë dhe brenda politikave që janë kryesisht në koncepte të gjera, si liberalizimi i tregut, i cili hap konkurrencën dhe rritë shfrytëzimin e resurseve që janë pronë e shtetit dhe krijon atraktivitet për investime. Këtë atraktivitet për investime e kanë përcaktuar në formatin e raportit, por ne nuk kemi pasur ku të bazohemi, përveç krahasimit me vitin paraprak. Nxjerrja e 21 akteve për rregullatorin, ku prej tyre janë 7 që e krijojnë bazën për shfrytëzimin efektiv të infrastrukturës dhe krijimin e konkurrencës efektive në treg, po e përmendi vetëm një, të drejtën e shtegut për përdorimin e kanaleve, tubacioneve ku shtrihen kabllot optike, e kemi sanksionuar me rregullore, ku secili pronar i infrastrukturës së telekomunikacionit ku kalon fibra, e ka për detyrë t'i japë tri opsione. Dhënie në shfrytëzim në kuadër të një çmimi me referent publik ku nuk mund të bëjë diskriminim kundër parashtruesit të kërkesës me rregullore, e kemi sanksionuar me rregullore që është referim i BE-së për shfrytëzimin e infrastrukturës së telekomunikacionit. Rregullimin klasik, duke përcaktuar tarifa, duke përcaktuar miratimin e tarifave, duke miratuar kontrata për konsumatorin, ndërsa rregullimi është bërë përmes politikave në vija të trasha, çka nënkupton kjo, nxjerr rregullore, nxjerr politika që krijon mundësinë për hyrje edhe të operatorëve virtualë, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në konkurrencën e tregut pakicë, pra ne nuk i rregullojmë çmimet me pakicë, por tregun e çmimeve me shumicë, për arsye se konkurrenca vetvetiu rregullon çmimet me pakicë, pra ky është koncepti rregullator i zbatuar në Republikën e Kosovës, i cili nuk është risi dhe nuk është jashtë praktikave të BE-së. Tani, me adaptimin e kornizës ligjore sekondare dhe ligjit që po hyn në fuqi, janë krijuar praktika të mira për shërbime në treg, duhet kuptuar se si funksionon operatori kur e ofron këtë pakon në paketa të kombinuara, internetin, telefoninë fikse edhe kabllorikun. Ne duhet ta kuptojmë sesi vjen çmimi për njësi. Sa i përket obligimeve të operatorëve për liberalizimin e mëtutjeshëm të telefonisë fikse, kemi shqiptuar sanksione të rënda, ashtu siç e parasheh ligji, pra ka filluar rregullimi, por si rezultat i një analize se çdo vendim i rregullatorit duhet të bazohet së paku në një arsye. Çdo vendim i rregullatorit është subjekt i apelimit në Gjykatën Supreme. Ne, aktualisht i kemi tri padi në Gjykatën Supreme nga operatorët për çështje të ndryshme tonat. Pra, këto janë çështjet më të mëdha të cilat në raport nuk kemi mundur t'i elaborojmë, për arsye se e kemi konsideruar si ngarkesë për ju sepse për ne janë gjëra të njohura. Sa i përket kualitetit të raportit, edhe pse nuk kemi bërë plane të projeksioneve afatshkurtra apo afatgjata, pa dalë te çështja e pavarësisë financiare. Qeveria, e cila është ekzekutiv i politikave, iu jep drejtim politik sesi do të avancojë sektorin e rregullimit të telekomunikacionit. Pa e pasur pavarësinë financiare, nuk mund të luash rolin e rregullatorit, sepse kjo është parakusht dhe është e sanksionuar me nenin 32 të kornizës së direktivës 1999/05, ku është kusht për anëtarësim dhe pavarësia e rregullatorëve, që mund të planifikojë vetvetiu, mund të parashtojë përgjegjësi publike, në mënyrë sesi e parasheh ligji. Për modalitetet tranzitore, ne kemi dhënë edhe propozime për këtë çështje, ndërsa një mundësi është, sepse ART-ja i ka katër burime të të hyrave: ka të hyra nga frekuenca, pra alokimi i frekuencave, alokimi i numrave, pra i enumeracionit të tarifave mbikëqyrëse, që është 0.3 të të hyrave bruto të gjobat dhe sanksionet. Ne kemi thënë për rregullatorin në gjendje aktuale në planifikimin trevjeçar që e kemi bërë në vitin 2010, por edhe në krahasim me ligjin e ri, kemi thënë se për rregullatorin mjaftojnë një milion euro për të arritur pavarësinë operacionale dhe funksionale, duke ndërtuar resurse nga 40 - 45 persona, prej tyre 30 janë zyrtarë profesionistë të fushës, dhe, maksimumi, 10 në administratë, por duke e bërë edhe ndarjen, si p.sh. ekspertët e fushës mund të kualifikohen si shërbyes civilë ku kjo në hapësirë mbetet që të rregullohet. Pse nuk e kemi shfrytëzuar buxhetin, këtë përqindje të buxhetit të shpenzimeve kapitale atëherë duhet të ketë së paku 20% nga të hyrat e frekuencave për me lejuar, që janë deri në tre milionë e gjysmë në vit dhe 500-700 mijë të tjera për t'i rikthyer një pjesë të të hyrave nga operatorët në sektor, përmes projekteve të ndryshme që i bëjnë konsumatorët, por kjo e fundit varet se sa shteti

do t'i japë prioritet sektorit të telekomunikimeve. Për procesin e privatizimit të PTK-së, aq sa na takon si rregullator, kemi dhënë procedurat formale që tregu i Kosovës ka potencial, ka atraktivitet, është atraktiv për investime të mëtutjeshme dhe oferta për privatizim është mjaft atraktive. Lidhur me çështjen e kodit se çka ka bërë ART-ja për vitin 2012, ne e kemi thënë edhe në vitin 2010 që ART –ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, i ka bërë të gjitha parapërgatitjet administrative, teknike, por siç dihet, kjo çështje është problem politik që po diskutohet dhe në dialogun që po zhvillohen në Bruksel midis Kosovës dhe Serbisë. Është me rëndësi të dihet nga ana e deputetëve se, si rezultat i qartësisë rregullatore, që i kemi mundësuar me këto akte, me këto vendime dhe me zbatim të ligjit, kontrata në këto dy vitet e fundit, me Monakon, nga rreth 20 milionë, aktualisht është gjashtë milionë euro kostoja financiare për kodin e marrë nga Monako ku mund të them se ende është e lartë me parametrat krahasues ndërkombëtarë dhe është shifër shqetësuese për detyrat të cilat i gjeneron sektori, ndërsa kjo si rezultat, në mes të tjerash, i atribuohet ART-së si progres dhe rezultat i qartësisë rregullatore. Kryetari pyeti edhe për kontradiktat në interpretim të dispozitave me ligjin aktual, problemin e vetëm deri më tani e kemi me tri institucione të cilat janë të njohura për ne, e që janë institucione publike dhe që ushtrojnë përgjegjësi ndërkombëtare në Kosovë dhe i referohen Marrëveshjes së Kumanovës, po flasim për KFOR-in, OSBE-në dhe MAP-in. MAP-i për ne e ka krijuar një rrjet më shumë resurse, e ka ndërtuar një rrjet i cili në kushte normale duhet t'i jepet tregut privat. Qeveria mund t'i pranojë shërbimet nga tregu privat, ndoshta mos të komentojmë me vlerë më të mirë dhe shërbime më të mira, por nuk është koha që në trendet evropiane të investojë shteti në shërbime publike të telekomunikacionit. Pyetja tjetër ishte nga znj. Sahataqia se a ka Kosova për gjeneratat e reja diçka lidhur me 3G, dhe mund të them se çka ka bërë në këtë drejtim ART-ja, pasi që në vendet e tjera evropiane është e tejkaluar, tek ne ende nuk është. ART-ja, kërkesa formale si e parashih ligji nuk ka pasur as nga VALA, as nga IPKO, ka pasur shprehje të interesit, por nuk ka pasur kërkesa si e parashih ligji. Ishte edhe një pyetje tjetër lidhur me investimet e PTK-së. Strukturat e investimeve të PTK-së në masa është përcaktuar edhe nga vendimet e ART-së e thamë në tetor të vitit të kaluar ART-ja ka nxjerrë vendimin, duke i dhënë berëz për vlerën 30 milionë euro ndaj Valës, për pjesën e mbetur për shtatë vite që është definitivisht 14 milionë euro dhe ata janë të obliguar që brenda një viti t'i bëjnë investimet në stacionet e teknologjisë, për t'i suportuar shërbimet e reja. Kjo ka qenë arsyeja pse shumica e 34 milionë eurove ka shkuar në tregun e telefonisë mobile. Ishte çështja e NVN- së, shumë e përfolur, ndërsa ne kemi deklaruar për procedura të rregullta ligjore ku çështja është shumë e pastër ligjorisht, kontrata është me standardet më të avancuara të sektorit, po flas politikat e sektorit që janë taksative ku deri në qershor të 2008 duhet të jepet së paku një licencë që obligon rregullatorin që të jepet një kornizë ligjore, në mënyrë që të mundësohet hyrja e tyre dhe ajo u plotësua. Z. Kelmendi pyeti se a ka sistem të bllobuar të kontrollit të trafikut, krejt ai trafik i cili gjeneron të gjitha tregjet, kalon në trurin elektronik të IPKO-s, pra nuk mund të ketë devijim. Ne kemi njohuri se sa është niveli i shfrytëzimit të infrastrukturës së Valës dhe sa e IPKO-s. Shfrytëzimi i tyre është nën optimumin dhe modele si këto vetëm e rritin performancën dhe kualitetin e rrjetave të cilat e kanë këta, pra i ndihmojnë ata për të rikthyer investimin, duke e bërë në mënyrë më efikase përmes të hyrave alternative dhe përfituesi kryesorë është VALA, për arsye se ata e bëjnë trafikun ata i marrin tarifat e terminit. Me ITU-në ne kemi bërë progres në dialog, kemi dhënë alternativat ku mbetet çështje politike, lidhur me digjitalizimin ne nuk parashohim që të bëhet digjitalizimi, sepse ne nuk e kemi një detyrim të tillë, janë ligje të tjera dhe nuk është çështje që rregullohet nga ne.

Ilir Imeri (ART) – Shtoi se lidhur me garancinë e konkurrencës, ku është e vërtetë se është përmendur në Raportin e Progresit, megjithatë këtu ka pasur përparim, këtu është zgjedhja dhe parazgjedhja e bartësit që e kemi adaptuar rregulloren në këtë vit. Po ashtu, janë krijuar të gjitha kushtet për t'u implementuar edhe analiza e tregut, dhe elementi i dytë, është probabiliteti i numrit. Këtu është një draft rregullore që është më tepër se një vit e gjysmë, dhe jo pse ne nuk mundemi ta adaptojmë si të tillë, por për shkak se është i pamundur implementimi i saj, duke

pasur parasysh se kjo ka implikime të mëdha financiare të implementimit të rregullores të portabilitetit të numrit edhe pas një periudhe të caktuar kohore. Kur ta marrim kodin, prapë duhet të shkohet me procedura të njëjta të blerjes së softuerëve dhe harduerëve.

Komisioni unanimitet nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, për vitin 2011.

Komisioni ia paraqet Kuvendit këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2011 i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për metrologji

Kryetari – Theksoi se tani ne kemi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për metrologji, të proceduar nga Qeveria dhe kërkoi që të formohet një grup i punës për shqyrtim.

Pas debatit, Komisioni unanimitet nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për metrologji.

Komisioni ia paraqet Kuvendit këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për metrologji.

Pas konsultimeve për formimin e grupit të punës, Komisioni unanimitet nxori këtë

V E N D I M

1. U formua grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për Metrologji.
2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Teuta Sahatqija- raportuese, Ramiz Kelmendi dhe Berat Buzhala- anëtarë.
3. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij.
4. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

6. Të ndryshme

a) Angazhimi i ekspertit për hartimin e ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale

Kryetari - Propozoi që në procesin e hartimit të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për miniera dhe minerale, të angazhohet eksperti Shyqyri Kelmendi, profesor universitar, në mbështetje të grupit të punës, përkatësisht Komisionit.

Propozimi u përkrah nga antarët e Komisionit.

b) Vendimi për masat mbrojtëse në çimento

Deputeti **Lutfi Zharku** kërkoi që të ftohet ministrja e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për raportim lidhur me vendimin për taksën për çimenton e importuar, të nxjerrë javën e fundit.

Kryetari Zenun Pajaziti tha se do të gjejë kohën e përshtatshme që të ftojë për raportim ministren e MTI-së, Mimoza Kusari-Lila.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit